

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË

DICTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë
Tel & Fax: (0390) 326 657
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471
info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

Datë : 30.12.2022

Nr: 921

**RREGULLORE PËR GATISHMËRINË EMERGJENTE DHE
PLANIFIKIMIN EMERGJENT**

Gjakovë

Dhjetor, 2021

Në mbështetje të nenit 34 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L – 087 për Ndërmarrjet Publike lidhur me nenin 20 të Ligjit nr.04/L-111 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 04/L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.10.2022 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR GATISHMËRIN EMERGJENTE DHE PLANIFIKIMIN EMERGJENT

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e masave për mbrojtje dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe në parandalimin dhe zvogëlimin e numrit të fatkeqësive dhe pengimi ose zvogëlimin e viktimave dhe të pasojave të tjera.
2. Mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, në suaza të drejtave dhe të detyrave të përcaktuara me ligj, e realizojnë:
 - a. shërbimet publike për mbrojtje dhe shpëtim në nivel qendror dhe komunal;
 - b. ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera;
 - c. shoqatat profesionale dhe shoqatat e organizatave joqeveritare; dhe
 - d. qytetarët e Kosovës;
3. Me qëllim të mbrojtjes së jetës së njerëzve dhe pasurisë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, në NP "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. në Gjakovë, në tekstin e mëtejshëm: "Ndërmarrja", duhen të merren masat dhe veprimet për mobilizimin e punëtorëve në çdo situatë fatkeqësie natyrore e punëtorëve të Ndërmarrjes dhe fatkeqësitë tjera për tejkalimin e krizës së krijuar.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, zvogëlimi i numrit të fatkeqësive, parandalimi si dhe zvogëlimi i numrit të viktimave dhe pasojave tjera nga fatkeqësitë e tilla.

2. Ndërmarrja është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në pajtim me kërkesat e ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera për subjektet për ofrimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
3. Sistemi i mbrojtjes përmban programimin, planifikimin, organizimin, menaxhimin, zbatimin, mbikëqyrjen, koordinimin dhe financimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera brenda ndërmarrjes.

Neni 3

Përgjegjësia e Ndërmarrjes

1. Ndërmarrja duhet të sigurojnë kushte dhe mundësi të nevojshme për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke si dhe implementimin e masave mbrojtëse të përcaktuara me ligj.
2. Ndërmarrja që përdorë, prodhon, transporton dhe deponon materie të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre dhe gazra energjetike dhe kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme, obligohen që të bëjnë vlerësimin e rreziqeve dhe të hartojnë plane të reagimit emergjent në pajtim me dispozitat ligjore.
3. Ndërmarrja me shpenzime të veta duhet të vendos dhe të mirëmbajnë pajisjet për ndërhyrje, të organizoj forcat e nevojshme për shpëtim dhe ndihmë, të siguroj lajmërimin dhe alarmimin e punëtorëve për rrezikun dhe të bashkë - financon aktivitetet përgatitore të nivelit lokal në proporcion me madhësinë dhe shkallën e rrezikut, të cilën e shkakton veprimtaria e sajë.
4. Në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, shpëtimi dhe mbrojtja e jetës së punëtorëve të Ndërmarrjes ka përparësi ndaj çdo aktiviteti tjetër për mbrojtje dhe për shpëtim.

Neni 4

Përgjegjësitë e Menaxhmentit

1. Menaxhmenti i ndërmarrjes ka për detyrë të:
 - a. kujdeset për implementimin e përgatitjeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
 - b. menaxhon mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;
2. Me qëllim të menaxhimit operativ dhe teknik të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, Menaxhmenti cakton Komandantin e Incidentit, apo menaxherin si dhe miraton planet e reagimit emergjent.

3. Komandanti i Incidentit apo Menaxheri dhe strukturat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni caktohen nga Kryeshefi i ndërmarrjes të cilët bashkëpunojnë me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim të Komunës, ku edhe i marrin urdhrat për aktivizimin e planit të reagimit me rastin e shfaqjes të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
4. Përcakton obligimet e të punësuarve në raste emergjente të cilët kanë përgjegjësi dhe autorizime të veçanta në aspektin e zbatimit të mbrojtjes nga rreziqet, si dhe merr masa ne rast të mos respektimin e detyrave të parapara me akte normative dhe urdhëresave të mbrojtjes nga rreziqet.
5. Përcakton obligimin e të punësuarve në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe merr masa për mos zbatimin e detyrave të parapara sipas rregulloreve të Ndermarrjes, apo për mos mobilizim, ose tejkalimin e detyrave në rastet emergjente nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
6. Stafi Menaxhues i Ndërmarrjes, gjatë realizimit të planit për kryerjen e detyrave të parapara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, duhet të bashkëpunon me të gjitha subjektet që duhen të ndihmojnë ekipet e reagimit emergjent siç janë:
 - a. Shërbimi Emergjent i Mjekësisë (SHEM);
 - b. Policia e Kosovës në Gjakovë (PKGJ);
 - c. Shërbimi i Zjarrfikësve (SH.Z);
 - d. FSK;
 - e. Kryqi i Kuq (OJQ);
 - f. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim pranë Kuvendi Komunal; dhe
 - g. Të gjitha subjektet të cilat ndihmojnë gjatë krizës;

Neni 5

Përgjegjësia e punëtoreve

1. Çdo punonjës e ka për detyrë që personit, të cilit i kanoset rreziku për jetë, apo shëndet, t'i ndihmojë, nëse në atë mënyrë nuk e rrezikon jetën e vet.
2. Obligimi i pjesëmarrjes në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë fillon nga mosha 18 vjeçare dhe zgjat deri në moshën 65 vjeçare për meshkujt, respektivisht 55 vjeç për femrat.
3. Nga detyrimi për të marrë pjesë në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë lirohen:
 - a. qytetarët që për arsye shëndetësore nuk mund t'i kryejnë detyrat e parapara;
 - b. gratë shtatzëna dhe nënat e fëmijëve nën 10 vjeç; dhe

- c. prindër i vetëm me një fëmijë nën 10 vjeç;
4. Të punësuarit në Ndërmarrje janë të detyruar të mobilizohen dhe të zbatojnë masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në raste emergjente.
5. Të punësuarit në Ndërmarrje janë të detyruar, që në mënyrë dhe kushtet e përcaktuara më Ligj, me mjetet e veta transportuese, teknike dhe mjetet tjera, si dhe me punën e vetë të marrin pjesë për tejkalimin e situatës emergjente nga rreziqet prej fatkeqësive natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, për shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë të rrezikuar në Ndërmarrje.
6. Lëndimi ose sëmundja, e cila shfaqet gjatë kryerjes së detyrave, aftësisimit dhe kryerjes së obligimeve materiale në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, trajtohet lëndim në punë ose sëmundje profesionale dhe pjesëtari gëzon të drejtat sipas dispozitave ligjore në fuqi.
7. Mbrojtja dhe shpëtimi nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, kanë karakter humanitar.

Neni 6

Përmbajta e planit të reagimit emergjent

1. Masat për mbrojtje dhe shpëtim, të cilat duhet t'i zbaton ndërmarrja (në tërësi apo sipas strukturave organizative) sipas vlerësimit të rrezikshmërisë, ashtu që masat e mbrojtjes duhet të përcaktohen veç e veç për të tri fazat sipas ligjit në fuqi.
2. Planet e reagimit emergjent përmbajnë:
 - a. Organizimin dhe mënyrën e zbatimit të mbrojtjes personale dhe reciproke të punëtorëve;
 - b. Pasqyrën e strukturës së institucionit me të dhënat për punëtorët, pajisjet dhe mjetet materialo-teknike të cilat do t'i përdor ndërmarrja në zbatimin e detyrave të saj;
 - c. Mënyrën e realizimit të bashkëpunimit me institucionet kompetente komunale dhe strukturat e mbrojtjes, shpëtimin dhe ndihmës;
 - d. Mënyrën e zbatimit të detyrave që janë të rëndësishme për mbrojtje dhe shpëtim;
 - e. Mënyrën e njoftimit dhe alarmimit;
 - f. Mënyrën e evakuimit;
 - g. Mënyrën e njoftimit të qendrës përkatëse 112;
 - h. Pasqyrën e personave përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, aktivizimin dhe angazhimin e tyre për secilën masë të planifikuar; dhe

- i. Pasqyrën e strukturave tjera të mbrojtjes dhe shpëtimit me të dhënat për udhëheqësit e tyre, adresat e tyre dhe numrat e telefonit, me qëllim të realizimit të bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke;
3. Shtojcat e planeve të reagimit emergjent përmbajnë edhe pjesën grafike në të cilën gjenden:
 - a. Pamja e ndërtesave, stabilimenteve apo objekteve tjera karakteristike;
 - b. Shenjat e destinimit të stabilimenteve dhe objekteve;
 - c. Burimet e rreziqeve;
 - d. Shtrirja maksimale e parashikuar e rreziqeve (zonat e skicuara);
 - e. Shenjat e rrugëve të mundshme për reagim (parësore dhe alternative);
 - f. Pamja e objekteve ku janë të vendosura pajisjet e mbrojtjes dhe shpëtimit;
 - g. Zonat e shënuara për grumbullimin e shpëtuesve (parësore dhe rezervë);
 - h. Rrugët e shënuara për evakuim;
 - i. Vendet për strehim (strehimoret – nëse ekzistojnë);
 - j. Pikat e shënuara për grumbullimin e të rrezikuarve;
 - k. Zonat e shënuara – vendet për strehimin dhe kujdesin ndaj personave të rrezikuar;
 - l. Vendet e shënuara për ofrimin e ndihmës së parë mjekësore;

Neni 7

Harmonizimi dhe përditësimi i planit

4. Plani e reagimit emergjent i ndërmarrjes duhet të harmonizohen me planet operative emergjente komunale.
5. Plani nga neni 6 i kësaj rregulloreje duhet të përditësohet atëherë kur në dokumentin "vlerësimi i rreziqeve" bëhen ndryshime të karakterit përmbajtjesor, të cilat ndikojnë në ndryshimin e zgjidhjeve të përcaktuara në plan.
6. Ndërmarrja duhet të bëjë përditësimin e të dhënave në shtojcat e caktuara të planit e reagimit emergjent siç janë: të dhënat personale, ndryshimi i adresave, numrave të telefonit, shpërbërja apo themelimi i strukturave të caktuara të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
7. Plani e reagimit emergjent i ndërmarrjes sipas ligjit ne fuqi duhet të rishikohet një (1) herë në vit.

Neni 8

Programi i trajnimeve

1. Ndërmarrja, me qëllim të zbatimit të detyrave do të siguroj trajnime për punëtorët që të jenë të përgatitur për veprim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
2. Programi i trajnimeve për pjesëtarët e ndërmarrjes në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera përbëhet prej trajnimeve bazike dhe të avancuara.
3. Trajnimet bazike dhe të avancuara nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhen prej pjesës së përgjithshme teorike dhe pjesës së veçantë teorike dhe praktike.
4. Pjesa e veçantë teorike e programit të trajnimeve bazike për kryerjen e punëve të mbrojtjes dhe shpëtimit përfshinë:
 - a. mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri;
 - b. mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore;
 - c. mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë tekniko-teknologjike, dhe
 - d. ndihmën e parë;
5. Pjesa e veçantë praktike e programit të trajnimeve bazike për kryerjen e punëve të mbrojtjes dhe shpëtimit për verifikimin e aftësive praktike të kandidatëve organizohen ushtrimet funksionale për:
 - a. fikjen e zjarrit, shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale të rrezikuara nga zjarri;
 - b. shpëtimin dhe largimin e të rrezikuarve jashtë zonës së rrezikuar;
 - c. mbrojtjen dhe shpëtimin gjatë vërshimeve dhe fatkeqësive tjera atmosferike në hapësirat e ndërmarrjes.
 - d. mbrojtjen dhe shpëtimin gjatë aksidenteve me materie të rrezikshme;
6. Zbatimi i plan programit nga ky nen i kësaj rregulloreje bëhet nga ligjërues të fushës juridike, ekonomike, menaxhimit emergjent dhe instruktorë të ndihmës së parë, mbrojtjes nga zjarri dhe zjarrfikës dhe shpëtimit.
7. Instruktorë të mbrojtjes nga zjarri dhe zjarrfikës dhe shpëtimit janë persona të cilët kanë diplomë apo certifikatë të fushës përkatëse.
8. Instruktorët për ndihmë të parë janë persona që kanë diplomë të fakultetit të mjekësisë apo certifikatë të vlefshme të lëshuar nga Kryqi i Kuq ose dokument të lëshuar nga institucioni përkatës.

Neni 9

Sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve

1. Për zbatimin e masave mbrojtëse shfrytëzohen forcat dhe mjetet në dispozicion të ndërmarrjes.
2. Ndërmarrja është e obliguar që për secilin objekt veç e veç si minimum të sigurojnë këto mjete dhe pajisje:
 - a. një komplet për dhënien e ndihmës së parë mjekësore nga paragrafi 2.b, të nenit 9 të kësaj Rregullore. Ky komplet sigurohet për hapësirën afariste në të cilën punojnë deri në 20 të punësuar,
 - b. më së paku një kuti të ndihmës së parë për çdo 20 deri 100 të punësuar, ndërsa në çdo 200 të punësuar të tjerë edhe nga një kuti të ndihmës së parë, e cila përmban:
 - fashë me skaje të thurura 10x5 – 2 copë;
 - fashë me skaje të thurura 4x5 – 5 copë;
 - fashë me skaje të thurur 5x6 – 5 copë;
 - fashë e prerë 8x5 – 3 copë;
 - gazë hidrofille $\frac{1}{4}$ metra – 4 copë;
 - gazë hidrofille $\frac{1}{2}$ m – 4 copë;
 - gazë hidrofille 1m – 2 copë;
 - gazë sterile $\frac{1}{4}$ metra – 3 copë;
 - gazë sterile $\frac{1}{2}$ metra – 2 copë;
 - gazë sterile 1 m – 2 copë;
 - kompresë hidrofille – 10 copë;
 - fashë e parë individuale TIP 2 – 2 copë;
 - vatë (pambuk) 50 gr – 1 paketim;
 - sanifiks 2x5 – 1 copë;
 - saniplast 10x4 – 5 copë;
 - gazë vazeline;
 - siguruese – 5 copë;
 - zhilet – 1 copë;
 - fashë turban nr. 0 a 1m – 1 copë;
 - Fashë turban nr. 0,2a – 1 m;
 - fashë turban nr. 2 a 1m – 1 copë;
 - mushama trekëndëshe – 2 copë;
 - alkool 70% dhe 1 jod (povidon);
 - c. një barelë (një vig për bartje) për çdo 50 të punësuar;
 - d. së paku një komplet mjetesh për dezinfektim të hapësirave afariste, hapësirave punuese të makinerive dhe automjeteve që shfrytëzohen në veprimtarinë afariste, e që përbën: 10 gram detergjent për çdo m² të hapësirës afariste ose 100gr kopitar për 1m² të sipërfaqes;

- e. së paku nga një komplet veglash i cili përfshinë: lopatë, kazmë, sëpatë, çekan, qyski, sharrë metalike, dara dhe matës të tensionit elektrik;

Neni 10

Mirëmbajtja e pajisjeve

1. Mjetet dhe pajisjet e përcaktuara me këtë Rregullore duhet të vendosen dhe ruhen në vend të përshtatshëm dhe të dukshëm, të mirëmbahen në gjendje funksionale dhe të shfrytëzohen vetëm sipas destinimit të tyre.
2. Mjetet e listuar sipas kësaj Rregullore të cilat kanë afat të kufizuar përdorimi, duhet të zëvendësohen para skadimit të këtij afatit, ndërsa ato të shpenzuara, dëmtuara apo në çfarëdo mënyre të humbura zëvendësohen, plotësohen më së largu në afat prej 60 ditësh nga dita e dëmtimit, respektivisht zhdukjes.

Neni 11

Vlerësimi i rrezikshmërisë

1. Ndërmarrja harton Planifikimin e aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si dhe për gjendje të jashtëzakonshme të cilat duhet të bazohen në vlerësimin e rrezikshmërisë.
2. Vlerësimin e rrezikshmërisë në nivel të Komunës nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera dhe gjendjen e emergjente e bën Drejtoria Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim (DKMSH).

Neni 12

Masat në rast të fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive tjera

1. Për raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera, parashihen këto veprime:
 - a. Masat emergjente për mobilizimin e të gjithë të punësuarve për tejkalimin e gjendjes emergjente sipas planit të hartuar për situatën e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
 - b. Organizimi dhe mënyra e kryerjes së kontrollit të brendshëm, autorizimet dhe detyrimet e të punësuarve të cilët kryejnë këtë kontroll, në rastet emergjente nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
 - c. Mënyra e njoftimit të punësuarve me rastin e themelimit të punës ose sistemimin nga një vend të punës, mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në atë vend të punës, si dhe aftësimin e punëtorëve mbi masat për mobilizim për tejkalimi e gjendjes në rastet emergjente në Ndr marrje, përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve për tejkalimin e situatës emergjente dhe mbajtja e shënimeve për këtë situatë;

- d. Llojet dhe sasia e pajisjeve dhe mjeteve për parandalimin e tyre në rastet e fatkeqësive natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, kur shpallet gjendja e jashtëzakonshme emergjente, sistemimi i këtyre pajisjeve dhe mjeteve, si dhe koha dhe mënyra për përdorimin e tyre për tejkalimin e gjendjes emergjente.
- e. Stafi i Ndërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim pranë Kuvendit Komunal, harton dhe përpilon planet për gatishmërinë emergjente dhe planifikimin emergjent nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera dhe një herë në vit verifikon gjendjen e planeve mbi gatishmërinë emergjente dhe planifikimin emergjent nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera.
- f. Për kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, organizohen njësitë dhe shërbimet e forcave dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, si vijon:
- Njësitë për ndihmë të parë mjekësore;
 - Njësitë teknik – shpëtimtarë;
 - Njësitë dhe shërbimet për mbrojtje radiologjike, kimike dhe biologjike;
 - Njësitë për evakuim dhe strehim;
 - Njësitë për sanimin e terrenit; dhe
 - Njësitë për fikjen e zjarrit;
2. Anëtarët e njësive, shërbimeve dhe të përbërjeve të tjera operative të shoqërive dhe të organizatave të tjera joqeveritare, gjatë kryerjes së detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, me rastin e fatkeqësive, përveç shenjave të veta, përdorin edhe shenjat e përkatësisë të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës.

Neni 13

Njoftimi për rrezikun

1. Ndërmarrja është e obliguar për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të mjeteve të paralajmërimit të cilat mundësojnë paralajmërimin e punëtoreve/qytetareve të rrezikuar drejtpërsëdrejti nga fatkeqësitë.
2. Çdo person është i obliguar që ta njoftoj qendrën më të afërt emergjente ose policinë për çdo rrezik nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë tjera sa më shpjet që e vëren apo kupton për të.

Neni 14

Evakuimi

Evakuimin nga objekti/et në rast të fatkeqësisë e organizon dhe zbaton Menaxhmenti i ndërmarrjes.

Neni 15

Shkaktimi i dëmeve dhe mbulimi i shpenzimeve

1. Personi fizik apo juridik i cili me qëllim apo për shkak të neglizhencës shkakton kërcënim që përfundon me kosto të intervenimit emergjent apo shkakton një aksident është i obliguar t'i mbuloj shpenzimet e:
 - a. intervenimeve për mbrojtje dhe shpëtim;
 - b. rimëkëmbjes dhe sanimit;
 - c. dëmeve të paguara për personat fizik dhe juridik.
2. Nëse kërcënimi apo aksidenti është shkaktuar nga më shumë se një person dhe nuk është i mundur identifikimi individual i tyre, ata janë përgjegjës për shlyerjen e shpenzimeve së bashku pa dallim.

Neni 16

Kompensimi

1. Pjesëtari, i cili ka pësuar dëme gjatë kryerjes së detyrave dhe të obligimeve në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, ka të drejtë kompensimi sipas Ligjit.
2. Pjesëtari i cili është i ngarkuar me obligime materiale, ka të drejtë në kompensim për përdorimin e mjeteve që i kanë dhënë për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, si dhe në kompensim dëmi, nëse ato janë dëmtuar ose shkatërruar.
3. Familja e ngushtë e pjesëtarit, që ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, apo obligimeve të tjera në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, ka të drejtë në kompensim financiar të pagës bazë nga Institucioni në të cilën ka punuar për një periudhë kohore të caktuar, me vendim të posaçëm, të drejtën për pension dhe të drejtën e shpenzimeve të transportit dhe varrimit në përputhje me rregullat për sigurim pensional, invalidor dhe sigurimin shëndetësor.

II. Dispozitat Përfundimtare

Neni 17

Ndryshim plotësimi


Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore behën nga organi i njëjtën i cili e ka miratuar këtë Rregullore. Në rast të çfarëdo paqartësie apo nevoje interpretimi dispozita ligjore e mbizotërojnë këtë rregullore.


Neni 18


Hyrja në fuqi


Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve dhe fillon të zbatohet nga data: 01.01. 2023.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të NP "Ngrohtorja e Qytetit" SHA në Gjakovë:



Kryesues,


Anëtarë/e,


Anëtarë/e,


Anëtarë/e,



Gjakovë, më 27.10.2022